



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE DURRËS

NOTER DONIKA M. BEQJA
ADRESA NR.4, EGNATIA, QENDRA
TREGTARE "BLUE STAR", KATI I
PARE
TEL: 0696952444

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1111

Nr. koleksioni: 676


Durres më 14/07/2023



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2023011180067080635



A2023011180067080635

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË “AAI – Golem 2010 ” Shoqeri e thjeshte)

Sot, më datë **14 Korrik 2023 (dymije e njezete e tre)**, para meje **Notere DONIKA M. BEQJA**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durrës, NR.4, EGNATIA, QENDRA TREGTARE "BLUE STAR", KATI I PARE, u paraqit personalisht:

SHITES:

Z.Illir Gjuzi, atësia Abdyl, amësia Salihe, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në KAVAJË, me adresë Kristal 04060080; Nd. 27; H. 1; Ap. 25; Golem; Kryemëdhej; 2504; Kavajë, lindur më 29/04/1962, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035009683 dhe nr. personal G20429091K, .

BLERES:

Z.Agim Shehu, atësia Nikollaq, amësia Mirjana, shtetas Shqiptar, lindur në Kurjan, Fier dhe banues në ROSKOVEC, me adresë Beqallaret 01600003; Nd. 5; H. 1; Kurjan; Mbërs; 9316; Roskovec, lindur më 16/01/1987, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033528756 dhe nr. personal I70116018I, .

Z.Artur Xhaferraj, atësia Mystehak, amësia Mynevere, shtetas Shqiptar, lindur në Mbjeshevë, Berat dhe banues në KAVAJË, me adresë Gjuzeve 04060058; Nd. 1; H. 1; Golem; Kryemëdhej; 2504; Kavajë, lindur më 14/07/1975, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034301898 dhe nr. personal H50714001T, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “AAI- Golem 2010 ” Shoqeri e Thjeshte., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA JURIDIKE E KONTRATES: Nenet 705 e vijues te Kodit Civil; 72-73 -74 te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per shoqerite tregtare” i ndryshuar me ligjin nr.10475 date 27.10.2011 dhe nr.129/2014; Ligji 131/2015 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” dhe Ligji nr.110/2018 date 20.12.2018 “Per Noterine”.

Mbeshtetur ne dispozitat e mesiperme ligjore, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote pasi u njohen me permbajtjen dhe efektet ligjore te ketyre dispozitave ne cilesite ligjore te mesiperme palet lidhin kete kontrate shitblerje duke bere deklarimet e meposhtme:

-Sikurse rezulton edhe nga ekstrakti i te dhenave te regjistrimit mare nga QKB ne date 07.07.2022.Pala Shitesese ne kete akt **shtetasi Ilir Gjuzi eshte ortak me 1 kuote ose 25 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise “A.A.I Golem 2010”**

regjistruar si person juridik në QKB me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M22728801F, me adresë Golem , Kryemëdhej, , Zona Kadastrale Nr.2291



A2023011180067080635

Po referuar ekstraktit të të dhenave të QKB kapitali i shoqërisë "AAI Golem 2010" rezulton të jetë 1000000 ALL dhe posedohet nga 3 ortakë :

-Agim Shehu 1(nje) kuote ne vleren 500.000 ALL ose 50 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqërisë.

-Artur Xhaferraj 1(nje) kuote ne vleren 250.000 ALL ose 25 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqërisë.

-Ilir Gjuzi 1(nje) kuote ne vleren 250.000 ALL ose 25 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqërisë.

NENI 1

Statusi juridik i kuotave/pjesëve objekt i kontratës

Ortaku Ilir Gjuzi në cilësinë e Pales Shitesë, e zoteron lirisht **kuoten** 25 % në kapitalin e shoqërisë të lire nga cdo barre apo detyrim tjetër real ligjor. Fakti u konfirmua edhe me kerkimin e bere nga une Noterja prane RBS konfirmimi qe mban daten 13.07.2023 - i bashkelidhet ketij akti

NENI 2

Pranimi i paleve

Me vendimin e dates **13.07.2023** të Asamblesë së Pergjithshme të ortakëve të shoqërisë AAI .Golem 2010, është vendosur shitja e kuotave të zotëruara prej ortakut Ilir Gjuzi në 25 % .

në kapitalin e kesaj shoqërie në favor të Pales Blerese në kete kontrate **Z.Agim Shehu** me të dhëna si më lart, në kuoten 10 %, dhe Z.Artur Xhaferraj në kuoten 15 % duke u pranuar që këta të fundit të jenë ortakë në : **Agim shehu në 60 % kuota të pjesemarrjes në kapitalin e shoqërisë Dhe Z Artur Xhaferraj në 40 % kuota të pjesemarrjes në kapitalin e shoqërisë .**

NENI 3

Cmimi i shitjes dhe menyra e likuidimit të tij, shfaqja e ligjshme e vullnetit

Duke marrë në konsideratë sa më lart me vullnet të lire, në ushtrim të së drejtës ligjore të disponibilitetit të pjesëve të zotëruara ligjorisht në kapitalin e shoqërisë, bazuar në ligjin për shoqëritë tregtare Pjesa IV (SHPK-të) Titulli II Kuotat dhe kalimi i kuotave nënë 72-75, konkretisht referuar nënë 73/1,b dhe 73/2 sipas të cileve :

"1.Kuotat e kapitalit të një shpk e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepërmjet: a)....,b) shitblerjes2.Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të behet me shkrim” ,

Pala Shitesë Ilir Gjuzi, në cilësinë e ortakut të shoqërisë, i shet Pales Blerese Agim Shehu që pranon ta blejë, **kuoten 10 % të zotëruar prej tij me vlerë 100.000 ALL në kapitalin e shoqërisë dhe i shet Pales Blerese Artur Xhaferraj** që pranon ta blejë, **kuoten 15 % të zotëruar prej tij me vlerë 150.000 ALL në kapitalin e shoqërisë**, vlerë e cila deklarohet prej paleve pa rezerva se do të likuidohet me kalim bankar në numrin e llogarisë të Z.Ilir Gjuzi.

Ky kalim do të behet menjehere pas nënshkrimit të kontratës. Po kështu pala shitesë **garanton për pronësinë e plote mbi kuoten** objekt disponimi me kete akt, fakt i konfirmuar edhe me konfirmimin e Regjistrisë të Barreve Siguruese date 13.07.2023.

Palet informohen se kalimi i pronësive ka efekt nga momenti i nënshkrimit të ketij akti .

NENI 4

Kalimi i së drejtës së pronësive mbi kuotat

Me nënshkrimin e ketij akti e drejta pronësive mbi kuoten e zotëruar nga ortakut Ilir Gjuzi në kapitalin e shoqërisë "AAI.Golem 2010" kalon në favor të Pales Blerese Artur Xhaferraj dhe Agim Shehu të cilet , bazuar në sa percakton Ligji nr.129/2014 date 02.10.2014 si dhe në vullnetin e shprehur të paleve, duke marrë në konsideratë sa u citua perfundimisht pas nënshkrimit të ketij akti, **do të jenë ortakë: Agim Shehu me 1 kuote në vlerën e 600000 ALL ose me 60% të pjesemarrjes në kapitalin e shoqërisë "AAI Golem 2010", ; Artur Xhaferraj me 1 kuote në vlerën e 400000 ALL ose me 40% të pjesemarrjes në kapitalin e shoqërisë "AAI Golem 2010",**

NENI 5

Efektet juridike të kalimit të pronësive

Me nënshkrimin e ketij akti dhe kalimin e së drejtës së pronësive mbi kuoten e zotëruar në kapitalin e shoqërisë G.I.Golem Alb, nga Pala Shitesë tek Pala Blerese, kalim i cili behet efektiv me



A2023011180067080635

regjistrimin e ketij akti ne QKB, Pala Blerese fiton te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga ky akt dhe merr persiper te gjitha detyrimet qe po ashtu derivojne prej tij.

Klauzole kompromisi.

Pala Blerese ne kete kontrate pranon pa rezerva se eshte njohur me faktin se subjekti nuk ka detyrime tatimore te palikujduara dhe mer persiper cdo detyrim tjeter te pa shlyer nga pala shitese.

Pala Blerese rikonfirmon vullnetin e saj per te blere kuoten e zoteruar nga **Pala Shitese** ne kapitalin e shoqerise "AAI.Golem 2010".

Pala blerese pranon cdo te drejte dhe detyrim te fituar nga shoqeria me palet e treta private apo shteterore nga momenti i nenshkrimet te ketij akti duke pranuar pergjegjesine brenda kufijve ligjore persa me siper.

NENI 6

Detyrimi per regjistrim

Palet marrin persiper te bejne regjistrimin e ketij akti prane QKB ne menyre qe kjo e fundit te beje ndryshimet perkatese (neni 71 /1,2 i ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" brenda 30 diteve nga data e nenshkrimet. Po keshtu ato jane te vetedijshme per faktin se publikimi i ketij ndryshimi ne te dhenat e shoqerise perben detyrim ligjor per secilen prej tyre.

Si u binda per ligjshmerine e marrjes se ketij akti, pasi verifikova dokumentacionin e kerkuar per kete akt, legjitimitetin e pjesemarrses persa i perket disponimeve te bera ne kete akt dhe u binda per vullnetin e saj lidhur me efektet juridike qe sjell ky veprim juridik per te, **redaktova personalisht kete akt ne kater ekzemplare** origjinale ne vlere dhe permbajtje, te perbera nga tre faqe.

Pas leximit te permbajtjes nga e sipercituara, forme e cila u ne menyre eksplicite si e vetme nga pala shitese, akti u nenshkrua prej te ketyre te fundit ne pranine time ne te gjitha ekzemplaret, si u kuptua dhe u gjend sipas vullnetit te shprehur, sa me siper ne respektim te neneve 102 pika 1 dhe 105/gj) te Ligjit nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine" pasi me deklaruan se e kuptojne dhe e aprovojne teresisht dhe pa rezerva ate.

Une Noterja sa me siper e vertetoj si per korrektesi ne permbajtje, ashtu edhe per origjinalitet ne nenshkrimet.

Ne zbatim te ligjit nr.9887 date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale" konkretisht neneve 2-39 informova te sipercituarit mbi perpunimin e te dhenave personale ne ushtrim te detyrimit ligjor per shkak te funksionit qe kryen Noteri dhe mora deklarimin e tyre se jane te pergjegjshme persa me siper dhe se aprovojne perpunimin e te dhenave sipas ligjit, sikurse edhe mora pelqimin e tyre mbi faktin se bazuar ne nenin 101/ 1 te Ligjit nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine" ketij akti i bashkelidhen kopje te dokumenteve te identifikimit te paleve dhe ne baze te nenit 105/ germa g) i bashkelidhet edhe dokumentacioni i paraqitur prej paleve.

PALET KONTRAKTUESE

SHITES

BLERES

Notere

DONIKA M. BEQJA

